

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, shpall për shitje si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Elbasan.

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)				Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)
			Vlera fillestare e shitjes (Mjete kryesore + mjete xhiro)	Mjetet kryesore	Mjetet xhiro	Trualli		
1	“Bodrum” nën pallatin Nr. 57	Elbasan	889 103	889 103	0	125 317	55 m ²	55m ² (Sip. takuese 9.17 m ²)

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
 - Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
 - Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
 - Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.
 - Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.
- Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë pasi të keni tërhequr pranë DDPP-së ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim: Publikimi bëhet për subjektet e shpronësuar (Shefqet e Mehmetali Stringa) në bazë të vendimit të AKKP-së nr. 238, datë 19.6.2009.

Publikimi bëhet për ish-pronarët (Mehmet e Shefqet Stringa) në bazë të vendimit të KKKP-së nr. 409/2, datë 22.2.1995.

Publikimi bëhet për ish-pronarin (Kasem Haxhihyseni) në bazë të vendimit të KKKP-së nr. 97/1, datë 1.6.1998.

Publikimi bëhet për ish-pronarin (Dhimitra Kanani) në bazë të vendimit të KKKP-së nr. 165/2, datë 31.5.1994.

Afati i publikimit fillon më datë 23.8.2019 dhe mbaron më datë 22.9.2019.